



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

REZOLUTË Nr. 1

Mbi sistemin e Ndhmës Ekonomike për Bashkinë Shkodër

Ne, të zgjedhurit vendorë me mandatin perfaqësues të komuniteteve vendore dhe banorëve të Shkodrës, Anëtarë të këshillit bashkiak Shkodër, pa dallime partiake e politike, në mbledhjen e këshillit bashkiak sot në datën 23 Shkurt 2018, në Shkodër;

Të shtyrë nga interesi legjitim i qytetarëve dhe komunitetit të Shkodrës për shërbime cilësore dhe llogaridhënie demokratike sa më pranë qytetarëve;

Bazuar në parimet universalisht të pranura të demokracisë dhe vetëqeverisjes vendore, mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 11, ligji nr.9355 /2005 “Per ndihmen dhe shërbimet shoqerore”, të ndryshuar;

Duke vlerësuar shqetësimin tonë të thellë dhe kundërshtimin bazuar në ligjin e ri, të trumbetuar me aq forcë nga qeveria, sistemi i Ndhmës Ekonomike menaxhohet në nivel qendror dhe jo më në Bashki. Por situata e sotme mund të quhet një ndër situatat më të zeza për familjet në nevojë në të gjithë Shqipërinë.

Më konkretisht, ku ka dështuar sistemi i ri i zbatuar nga Janari i këtij viti:

1. Sistemi nuk ka informacion të përditësuar në lidhje me personat e regjistruar pranë zyrave të punës si punëkërkuës të papunë. **Janë hequr padrejtësisht familje që i kanë të gjithë anëtarët të papunë.**
2. Sistemi nuk bën dallimin mes punëkërkuësit dhe studentit (me vërtetim shkolle), pasi studenti nuk ka detyrim regjistrimi në zyrën e punësimit si punëkërkuës. **Kështu janë hequr nga skema padrejtësisht të gjithë familjet që kanë fëmijët studentë, familje të varfra dhe pa të ardhura familjare.**
3. Sistemi nuk ka të dhënat e përditësuara mbi pronësinë e automjeteve. **Kjo ka shkaktuar përjashtimin e padrejtë të familjeve që nuk disponojnë realisht mjete.**

4. Sistemi gjeneron familje që rezultojnë me dy gjendje civile (në dy qarqe ose në dy bashki të ndryshme). **Rastet e familjeve që kanë anëtarë të burgosur, janë përjashtuar padrejtësisht.**
5. Sistemi është jo transparent. Askush nuk ka informacion lidhur me kriteret e llogaritjes së pikëve. Sistemi i pikëzimit nuk sqaron pamjaftueshmërinë e pikëve për familjet me një ose me më shumë anëtarë. **Kjo ka shkaktuar konfuzion dhe revoltë për të gjithë familjet që janë përjashtuar dhe që deri më tani Bashkitë i kanë trajtuar me ndihmë ekonomike.**
6. Sistemi nuk favorizon familjet njëprindërore me femijë në ngarkim. **Përgjithësisht sistemi ka penalizuar gratë kryefamiljare më në nevojë.**
7. **Sistemi ka penalizuar një numër shumë të madh të familjeve që kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuar ose invalidë pune.**

Në cilësinë e anëtarëve të këshillit të bashkisë Shkodër, i kërkojmë Qeverisë:

- 1- Pezullimin e menjëhershëm të kësaj skeme që në vend të zbutjes e thellon varfërinë.
- 2- Shfuqizimin e menjëhershëm të vendimit të Shërbimit Social Shtetëror për ndihmën ekonomike të muajit Janar për gjithë Shqipërinë.
- 3- Rishikimin e kuadrit normativ për ndihmën ekonomike në koordinim dhe konsultim me Shoqatat e Bashkive.

Miraturar në mbledhjen e datës 23.2.2018

Sekretar i këshillit
Suel Hadri

K R Y E T A R
Xhemal BUSHATI